



Prishtinë, 15 korrik 2016
Kodi i ZRRE-së: V_832_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-741-2015 të datës 16 korrik 2015 për shoqërinë N.T.SH.“Eling”, se ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, në Komunën e Graçanicës, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, në Komunën e Graçanicës, të datës 24.06.2016, të shoqërisë N.T.SH.“Eling”, me adresë: „Dardania“ SU 1/1 Hyr. 2 Nr. I-b,10000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 15 korrik 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_741_2015 i datës 16 korrik 2015, i lëshuar shoqërisë N.T.SH.“Eling”, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 16 janar 2017**.
- II. Shoqëria **N.T.SH.“Eling”**, obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, në Komunën e Graçanicës, gjegjësisht deri me datën **16 janar 2017** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi
- III. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-741-2015 i datës 16 korrik 2015 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 26.01.2015 nga shoqëria **N.T.SH.“Eling”**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për ndërtimin e kapaciteteve të

